



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZLAnr.30/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevc, anëtarë dhe me zyrtarin e lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Vushtrri, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankes nga përfaqësuesi i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor-(KKZ), në Vushtrri, me të cilin pretendon se subjektit politik AKR në mënyrë drastike ju është shkelur e drejta me pjesëmarrjen e numrit të komisionerëve, pasi që AKR përfaqësohet me 3 deputet në kuvendin komunal në Vushtrri dhe se ky subjekt politik ka kandidat për kryetar të Vushtrris.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi bazën juridike për paraqitjen e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se në rastin konkret PZAP-i nuk shqyrton dhe nuk vendos ndaj njoftimeve të KKZ-ve por vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së dhe me këtë rast parashtresuesi i ankesës nuk ka bazë ligjore për ankimitimin e njoftimeve të KKZ-së, sepse është e specifikuar qartë në dispozitën ligjore të nenit 122 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, se në cilat raste mund të ankimohen vendimet e KQZ-së.

Për arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr. 30/2017 më datën 15.09.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.